



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 750/5 prot.

Tiranë, më 30.5.2024

V E N D I M

Nr. 22, datë 30.05.2024

PËR  
KËRKESËN E PARAQITUR NGA Znj. S V

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" si dhe në Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës,

Referuar kërkesës së paraqitur nga Znj. S V pranë Këshillit Drejtues, më të cilën ajo ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 10, datë 16.04.2024 "Për miratimin e raportit për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve që kanë aplikuar për provimin e pranimit për vitin akademik 2024-2025",

Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 30.05.2024,

KONSTATON SE:

Znj. S V ka paraqitur kërkesë pranë Këshillit Drejtues, më të cilën ajo ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 10, datë 16.04.2024 "Për miratimin e raportit për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve që kanë aplikuar për provimin e pranimit për vitin akademik 2024-2025".

Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Znj. S V, dhe konkludoi se nuk ka asnjë rrethanë apo provë të re, të ndryshme nga ato të paraqitura në Shkollën e Magjistraturës në momentin e aplikimit për të marrë pjesë në konkursin e provimit të pranimit për vitin akademik 2024-2025, që të legjitimojë kërkesën për rishikim të vendimmarrjes së organit administrativ.

Këshilli Drejtues arsyeton edhe njëherë se aplikantja, znj. S V, nuk përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme të lëndëve në programin e studimit, kërkesë e cila është e parashikuar në ligj dhe në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Për këtë arsye, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës,

## VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së znj. S V për rishikim të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 10, datë 16.04.2024 *“Për miratimin e raportit për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve që kanë aplikuar për provimin e pranimit për vitin akademik 2024-2025”*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.